



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:128177
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825954

K.DH.SH.II.nr.148/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Meridian Corporation” shpk, me numër unik identifikues 810482521 me seli ne Prishtinë te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “SCLR Partners” me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë te cilin e përfaqësojnë sipas autorizimit Arianit Koci dhe Granit Vokshi avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, te ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1735/22 dt.30.10.2023, me datën 14.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “Meridian Corporation” shpk, me numër unik identifikues 810482521 me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1735/22 dt.30.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1735/22 dt.30.10.2023, ne pjesën e parë te dispozitivit te aktvendimit ka aprovuar pjesërisht prapësimin debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrin përmbarimor P.nr.268/22 dt.31.05.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha, sa i përket shumes se detyrimit prej 10,868.09 euro. Ne pjesën e dytë te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar pjesërisht prapësimin e debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.268/22 dt.31.05.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha për pjesën e detyrimit ne shumen prej 8,957.85 euro.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktvendimin e atakuar në pjesën e I të dispozitivit ta ndryshoj dhe ta lë në fuqi urdhrin përbarimor edhe për pjesën e detyrimit prej 10,868.09 euro dhe të vërtetohet në tërësi si e bazuar edhe pika e II e dispozitivit të aktvendimit të atakuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Meridian Corporation” shpk, me numër unik identifikues 810482521 me seli në Prishtinë, me datën 31.05.2022, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.20028544 dt.15.08.2020, 20031504 dt.02.09.2020, 20035346 dt.25.09.2020. Përbaruesi Privat Fadil Hoxha, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.268/22 dt.31.05.2022, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të borxhit nga faturat kreditorit t’i paguaj shumën e detyrimit prej 19, 825.94 euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 13.06.2022, me arsyetimin se faturat mbi bazën e të cilave mbështetet urdhri përbarimor nuk plotësojnë kushtet ligjore që dalin nga neni 29 par.3 të LPP, debitori cek se ka realizuar fatura të rregullta të cilat kapin shumën prej 3,900.00 euro ndërsa pjesa tjetër e faturave të pretenduara nga kreditori janë të parregullta dhe të panjohura pasi që nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga vet debitori. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj urdhrin përbarimor dhe ta obligoj debitorin të paguaj shpenzimet e procedurës për përpilim të prapësimin në shumën prej 208 euro sipas tarifës së OAK.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 17.06.2022, kreditori ka parashtruar përgjigje, përmes së cilit pretendon se arsyet e dhëna nga debitori në prapësim janë të pabazuara sepse faturat e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm nga neni 29 par.3 e LPP, janë të nënshkruara nga debitori dhe janë të përshtatshme për përbarim, ndaj propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1735/22 dt.30.10.2023, me të cilin e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke anuluar pjesërisht urdhrin përbarimor si dhe ka refuzuar pjesërisht prapësimin

e debitorit duke lënë pjesërisht në fuqi pjesën tjetër të urdhrit përmbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit gjykata i referohet nenit 29 par.1.3 dhe par.3 dhe nenit 37 të LPP dhe në mbështetje të këtyre dispozitave gjykata vendos si në piken e parë të dispozitivit pasi vlerëson se faturat nr.20031504 dt.02.09.2020 dhe 20035346 dt.25.09.2020 nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme ngase nuk ka dëshmi se të njëjtat i janë dorëzuar debitorit apo se debitori i ka pranuar këto fatura dhe detyrimin që rrjedh nga të njëjtat. Ndërsa si në piken e dytë të dispozitivit gjykata vlerëson se fatura nr.20028544 dt.15.08.2020 i përmban të gjitha tiparet e një dokumenti të besueshëm siç kërkohet me nenin 29 par.3 të LPP sepse përmban të dhënat për palët, mallrat dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga debitori e po ashtu edhe kohën e përmbushjes. Fatura është pranuar nga debitori është e nënshkruar nga i njëjti dhe se në lidhje me këtë faturë debitori ka lëshuar dëshmi për pranimin e mallit në momentin e dorëzimit dhe se nga këto arsye gjykata vlerëson se debitori ka qenë në dijeni për detyrimin që buron nga kjo faturë. Sa i përket pagesave të bëra përmes bankës nga debitori dt.30.03.2021, 29.01.2021 dhe dt.05.02.2021, e të cilat debitori ia ka bashkangjitur prapësimit, gjykata vlerëson se nga këto pagesa nuk rezulton se debitori ka kryer pagesë në emër të faturës objekt i përmbarimit, andaj nga këto arsye gjykata ka vendosur edhe si në dispozitivin të aktvendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se faturat nr.20031504 dt.02.09.2020 dhe 20035346 dt.25.09.2020 mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme konform nenit 29 par.3 të LPP i cili parasheh që se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, si edhe Udhëzimi Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, ngase këto fatura nuk janë nënshkruar dhe as vulosur nga debitori si dhe në shkresa të lëndës nuk rezulton me prova se faturat i janë dorëzuar debitorit apo se debitori i ka pranuar të njëjtat në mënyrë të rregullt nga kreditori.

Ndërsa sa i përket faturës nr.20028544 në bazë të cilës është lejuar përmbarimi, edhe kjo gjykatë vlerëson se kjo faturë i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sepse debitori ka pranuar të njëjtën me vet faktin se ka lëshuar dëshmi mbi pranimin e mallit nga kreditori nr.WRP-19-0004319 dt.15.08.2020 e vulosur dhe nënshkruar nga debitori dhe Fletë kthim të mallit të shitur me nr. 01369 dt.15.08.2020 e cila dëshmi përmban nënshkrimin e debitorit, andaj fakti se debitori ka lëshuar dëshmi mbi pranimin e mallit nga fatura edhe kjo gjykatë konsideron se i njëjti e ka pranuar faturën si dhe detyrimin që rrjedh nga e njëjta.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kjo gjykatë ka analizuar pretendimet ankimore te kreditorit por se te njëjtat i vlerësoj si te pabazuara dhe te paargumentuara, andaj edhe i refuzoi si te tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.148/24, me datë 14.06.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi